



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo
ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT
TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKE
PROCUREMENT REVIEW BODY



Organi Shqyrtues i Prokurimit (OSHP) – Rruga Migjeni (ish Banka e Ljublanës), Kati V-të, Prishtinë, Kosovë
Tel: 383 38 312 309 email: oshp@rks-gov.net

OSHP: 2025/1118

Paneli Shqyrtues, i emëruar nga U.D Kryetari i OSHP-së, në bazë të nenit 105, 106, dhe 117 të Ligjit për Prokurim Publik të Republikës së Kosovës (Ligji nr. 04/L-042, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin 04/L-237, Ligjin 05/L-068, i plotësuar dhe Ligjin 05/L-092) në përbërjen nga Kimete Gashi Brajshori duke vendosur sipas ankesës së OE ASSET ING SH.P.K., kundër Vendimin për anulimin e procedurës së prokurimit lidhur me aktivitetin e prokurimit “Largimi, trajtimi dhe deponimi i materialeve të rrezikshme në Kryeqytet” me numër të prokurimit 616-25-6217-5-2-1, inicuar nga autoriteti kontraktues (AK) – KUVENDI I KOMUNES SE PRISHTINES, më 16/12/2025, mori këtë:

Vendim

1. **Aprovohet**, si pjeserisht e bazuar ankesa e ASSET ING SH.P.K., me nr. 2025/1118, e datës 12/11/2025, lidhur me aktivitetin e prokurimit “Largimi, trajtimi dhe deponimi i materialeve të rrezikshme në Kryeqytet”, me numër të prokurimit 616-25-6217-5-2-1, inicuar nga autoriteti kontraktues – KUVENDI I KOMUNES SE PRISHTINES.

2. **Mbetet në fuqi** B58 Njoftimi mbi Vendimin e Autoritetit Kontraktues - KUVENDI I KOMUNES SE PRISHTINES për aktivitetin e prokurimit “Largimi, trajtimi dhe deponimi i materialeve të rrezikshme në Kryeqytet”, me numër të prokurimit 616-25-6217-5-2-1.

3. Lejohet kthimi i mjeteve të depozituara në emër të tarifës ankimore sipas paragrafi 4, 5 të nenit 31 të Rregullores së Punës së OSHP, kurse ankuesi ka të drejtë që sipas paragrafi 6, të dispozitës së cituar, të kërkojë kthimin e mjeteve në afat prej gjashtëdhjetë (60) ditësh nga data e pranimit të këtij vendimi, në të kundërtën mjetet konfiskohen dhe kalojnë në Buxhetin e Republikës së Kosovës.

Arsyetim

- Faktet dhe rrethanat procedurale -

Me 16.07.2025 KUVENDI I KOMUNES SE PRISHTINES, duke vepruar në cilësinë e Autoritetit Kontraktues, ka paraqitur Njoftimin për kontratë, për aktivitetin e prokurimit “Largimi, trajtimi dhe deponimi i materialeve të rrezikshme në Kryeqytet” me numër të prokurimit 616-25-6217-5-2-1.

Autoriteti kontraktues ka zbatuar procedurë të hapur, lloji i kontratës: punë, vlera e parashikuar e kontratës: **50,000€**.

Me 22.10.2025 KUVENDI I KOMUNES SE PRISHTINES, duke vepruar në cilësinë e Autoritetit Kontraktues, ka publikuar Njoftimin mbi vendimin (B58), ku është anuluar aktiviteti i prokurimit.

Me 25.10.2025, OE ankues ka parashtruar kërkesë për rishqyrtim ku me datë 03.11.2025 AK e ka refuzuar si të pa bazuar kërkesën për rishqyrtim.

Me 12.11.2025, OE ASSET ING SH.P.K., ka parashtruar ankesë në OSHP, e cila është evidentuar me numër protokolli 2025/1118, duke e atakuar Vendimin e cituar si më sipër të AK, për anulim të aktivitetit.

-Mbi fazën e shqyrtimit paraprak-

Organi Shqyrtues i Prokurimit ka konstatuar se ankesa i përmban të gjitha elementet e përcaktuara përmes nenit 111 të LPP dhe si e tillë është parashtruar brenda afatit ligjor në përputhje me nenin 109 paragrafin 1 të LPP pas procedurës paraprake për zgjidhje të mosmarrëveshjeve në kuptim të nenit 108/A të LPP, nga operatori ekonomik që është palë e interesuar sipas nenit 4 paragrafit 1 nën-paragrafit 26 të LPP. Në këtë mënyrë Organi Shqyrtues i Prokurimit ka konstatuar se është kompetent për të shqyrtuar këtë ankesë sipas nenit 105 të LPP dhe nuk ekziston asnjë pengesë procedurale për të vazhduar me shqyrtimin e ankesës në mënyrë meritore.

Pretendimet e operatorit ekonomik ankues ASSET ING SH.P.K., janë parashtruar si në vijim:

Autoriteti Kontraktues, respektivisht Komuna e Prishtinës, me datë 22.10.2025, ka publikuar Njoftimin mbi Vendimin e AK-së. Në vendimin e publikuar, AK ka anuluar aktivitetin e prokurimit për mungesë të ofertave të përgjegjshme. Në përputhje me nenin 108/a të LPP-së kemi parashtruar Kërkesë për rishqyrtim brenda afateve kohore, respektivisht me datë 24.10.2025. Me datë 03.11.2025, AK ka nxjerrë Vendimin për refuzim të Kërkesës për Rishqyrtim.

Në kërkesën tonë paraprake për rishqyrtim kemi argumentuar në mënyrë të detajuar secilën pikë të pretenduar nga AK. Megjithatë, AK nuk është marrë me asnjë nga pretendimet tona konkrete, duke dhënë vetëm një përgjigje të përgjithshme, në të cilën thuhet:

"Lidhur me pretendimet ankimore të parashtruesit sa i përket arsyeve eliminuese të prezantuara në letrën standarde përmes së cilës parashtruesi është eliminuar si i papërgjegjshëm, është gjetur që arsyet e evidentuara nga komisioni vlerësues janë të sakta, të matshme dhe të ligjshme. Rrjedhimisht, është gjetur se eliminimi i parashtruesit është bërë në mënyrë të drejtë. Nga sa u tha më sipër, kërkesa për rishqyrtim e parashtruesit është refuzuar si e papabazuar në tërësi."

Ky vlerësim nuk përmban asnjë analizë materiale apo ligjore për pretendimet tona, dhe për këtë arsye është i papabazuar dhe në kundërshtim me dispozitat e LPP-së, i cili obligon AK-në që të japë arsyetim të detajuar për çdo pretendim të parashtruar nga operatori ekonomik.

Si rrjedhojë, më poshtë gjeni pretendimet tona.

Në lidhje me pretendimin 1: Arsyeja e refuzimit të ofertës sonë është si vijon: GOE për kërkesën e detyrueshme “Deklarata për themelimin e grupit GOE”, kjo ofertë është e papërgjegjshme, sepse janë ngarkuar dy deklarata të ndryshme, me ndarje të ndryshme të përgjegjësi. Anëtar i konsorciumit EKO-TEAM DOO ka paraqitur një deklaratë të veçantë ku ka deklaruar se është pjesëmarrës me OE ASSET ING SH.P.K. si lider me 80% pjesëmarrje, ndërsa vetë me 20% pjesëmarrje në ekzekutimin e punimeve, ndërkohë që në deklaratën tjetër janë paraqitur përqindje të ndryshme dhe janë shtuar edhe dy OE të tjerë. Argumenti ynë Neni 26.15 i Rregullores së Prokurimit Publik përcakton se: “Kurdo që operatorët ekonomikë marrin pjesë si grup, grupi i operatorëve ekonomikë, së bashku me ofertën e tyre, duhet të ofrojnë një marrëveshje për themelimin e grupit, në të cilën anëtarët e grupit do t’i përcaktojnë të drejtat dhe përgjegjësitë, si dhe të gjitha veprimet procedurale që duhet t’i kryejë lideri i grupit në emër të grupit. Autoritetet kontraktuese duhet ta vendosin këtë kërkesë në Dosjen e Tenderit, si dhe formën standarde të marrëveshjes të hartuar dhe miratuar nga KRPP.”

Përkundër faktit që Autoriteti Kontraktues nuk e ka vendosur këtë kërkesë në Dosjen e Tenderit, por vetëm ka ngarkuar një formë standarde të paplotë, e cila nuk është në përputhje të plotë me versionin e miratuar nga KRPP, ne si Operator Ekonomik kemi shkarkuar formën standarde zyrtare nga platforma elektronike e KRPP-së dhe e kemi plotësuar në përputhje me nenin 26.15 të Rregullores së Prokurimit Publik.

Prandaj, eliminimi i ofertës sonë për këtë pikë është i papranueshëm, pasi ne kemi përmbushur kërkesën në përputhje me dispozitat e Rregullores së Prokurimit Publik.

Me këtë veprim, Autoriteti Kontraktues ka bërë shkelje të nenit 59 të Ligjit për Prokurimin Publik dhe nenit 26.15 të Rregullores së Prokurimit Publik. Bashkëngjitur gjeni Deklaratën e plotësuar për Themelimin e Grupit, deklaratë e dorëzuar me ofertë.

Në lidhje me pretendimin 2: Arsyeja e refuzimit të ofertës sonë është si vijon: Nuk është dëshmuar leja/pëlqimi mjedisor për grumbullimin, ndarjen dhe trajtimin e mbeturinave të ndërtimit dhe rrënojave, të lëshuar nga Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës ose nga Komuna. Leja e paraqitur nuk është e destinuar për azbest sipas kërkesës dhe Aneksit 1 të detyrueshëm. Argumenti ynë Kërkesa e parashtruar në Dosjen e Tenderit (DT): Operatori ekonomik duhet të ketë pëlqim mjedisor për Grumbullimin, Ndarjen dhe Trajtimin e Mbeturinave të Ndërtimit dhe Rrënojave të lëshuar nga Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës ose nga Komuna. Dëshmia e kërkuar: Operatori ekonomik duhet ta dëshmojë këtë me kopje të pëlqimit mjedisor për Grumbullimin, Ndarjen dhe Trajtimin e Mbeturinave të Ndërtimit dhe Rrënojave, të lëshuar nga Ministria ose nga Komuna përkatëse. AK ka refuzuar ofertën tonë me arsyetimin se leja e paraqitur nuk është e destinuar për azbest, sipas kërkesës dhe Aneksit 1 të detyrueshëm. Në Dosjen e Tenderit është kërkuar kopje e pëlqimit mjedisor për Grumbullimin, Ndarjen dhe Trajtimin e Mbeturinave të Ndërtimit dhe Rrënojave, dhe në përputhje me këtë kërkesë ne kemi dorëzuar pëlqimin mjedisor të lëshuar nga Komuna. Ky pëlqim mjedisor përmbush plotësisht kushtin e parashtruar në DT. Prandaj, eliminimi i ofertës sonë për këtë pikë është i papranueshëm, pasi ne kemi përmbushur kërkesën në përputhje me kërkesën e parashtruar në DT. Me këtë veprim, Autoriteti Kontraktues ka bërë shkelje të nenit 59 të Ligjit për Prokurimin Publik. Bashkëngjitur gjeni Pëlqimin mjedisor të lëshuar nga Komuna.

Në lidhje me pretendimin 3: Arsyeja e refuzimit të ofertës sonë është si vijon: GOE lidhur me kërkesën nr. 3 të DT-së.a. Operatori ekonomik duhet të ofrojë dëshmi të pranueshme se qarkullimi vjetor i OE ose i grupit të OE gjatë 3 viteve të fundit (për tri vitet bashkë) ka qenë në

vlerë jo më pak se 100,000.00 €.Dëshmia e kërkuar:a. Deklaratat Tatimore Vjetore të dorëzuara në Administratën Tatimore të Kosovës (për tri vitet e fundit).GOE për këtë pikë është e papërgjegjshme, sepse me ofertën e tij ka dorëzuar një deklaratë në gjuhën maqedonase dhe për këtë pikë është e papërgjegjshme dhe jo bindëse.Argumenti ynëKërkesa e parashtruar në Dosjen e Tenderit (DT):Operatori ekonomik duhet të ofrojë dëshmi të pranueshme se qarkullimi vjetor i operatorit ekonomik ose i grupit të operatorëve ekonomikë gjatë tre (3) viteve të fundit (për tri vitet së bashku) ka qenë në vlerë jo më pak se 100,000.00 €.Dëshmia e kërkuar:Deklaratat tatimore vjetore të dorëzuara në Administratën Tatimore të Kosovës për tri vitet e fundit.AK ka vlerësuar se jemi të papërgjegjshëm, me arsyetimin se në ofertë është dorëzuar një deklaratë tatimore në gjuhën maqedonase, duke konsideruar këtë dokument si jo bindës dhe të papranueshëm për këtë pikë të DT-së.Ne nuk e kontestojmë vlefshmërinë e nenit 13.4 të Ligjit për Prokurimin Publik (LPP), por konsiderojmë se interpretimi dhe zbatimi i tij në këtë rast nga AK është i gabuar dhe i paarsyeshëm, për arsyet e mëposhtme:Dokumentet mbi qarkullimin vjetor janë dokumente mbështetëse që dëshmojnë kapacitetin financiar të operatorit ekonomik.Sipas Opinionit nr. 66, datë 10.07.2019, të KRPP-së, vetëm specififikimet teknike të produktit të dorëzuara në gjuhë tjetër nga ato të lejuara përbëjnë arsye për përjashtim, pasi pengojnë analizën teknike të ofertës. Ndërsa për dokumentet si referencat, certifikatat dhe dëshmitë, KRPP ka theksuar se AK duhet të kërkojë përkthim zyrtar, në përputhje me nenin 72 të LPP-së, në vend që të eliminojë ofertën.Neni 72 i LPP-së përcakton qartë se në rast të pasaktësive ose mungesës së dokumenteve mbështetëse, Autoriteti Kontraktues mund të kërkojë sqarime ose plotësime nga operatori ekonomik, me qëllim që të sigurohet interpretim i drejtë dhe i plotë i ofertës. Në këtë rast, AK nuk ka ushtruar këtë kompetencë ligjore dhe ka vepruar në mënyrë disproporcionale, duke eliminuar ofertën pa dhënë mundësi për përkthim apo sqarim.Sipas interpretimit të KRPP-së (10.07.2019), përjashtimi i ofertës për shkak të gjuhës është i arsyeshëm vetëm kur dokumentet janë thelbësore dhe pengojnë procesin e vlerësimit, gjë që nuk vlen për dokumentet e qarkullimit financiar, të cilat mund të përkthehen pas kërkesës së AK-së.Përjashtimi i ofertës sonë cenon parimin e proporcionalitetit dhe të trajtimit të barabartë të operatorëve ekonomikë, pasi AK kishte mundësi ligjore të kërkonte përkthimin zyrtar të dokumentit, por nuk e ka bërë. Si rezultat, AK ka shkelur nenin 72 të LPP-së dhe Opinionin nr. 66 të KRPP-së, duke eliminuar ofertën në mënyrë të pajustificuar dhe jo proporcionale me natyrën e shkeljes.

Në lidhje me pretendimin 4:Arsyja e refuzimit të ofertës sonë është si vijon:GOE lidhur me kërkesën nr. 4. Operatori Ekonomik duhet të posedojë certifikime, t'i prezantojë certifikatat EN ISO 9001, EN ISO 14001, BS ISO 45001 dhe ISO IEC 17025.Dëshmia: Certifikatat.GOË për këtë pikë nuk ka ofruar dëshmi, certifikatë për ISO IEC 17025.Argumenti ynëKërkesa e parashtruar në Dosjen e Tenderit (DT):Operatori ekonomik duhet të posedojë certifikimet dhe t'i prezantojë certifikatat EN ISO 9001, EN ISO 14001, BS ISO 45001 dhe ISO/IEC 17025.Dëshmia e kërkuar:Certifikatat.Arsyetimi i Autoritetit Kontraktues (AK):GOË për këtë pikë nuk ka ofruar dëshmi, certifikatë për ISO/IEC 17025.Ne nuk pajtohemi me këtë konstatim të AK-së, për arsyet e mëposhtme:Ne kemi dorëzuar certifikatën ISO/IEC 17025 në ofertë. Kjo certifikatë është lëshuar për laboratorin me të cilin kemi kontratë bashkëpunimi. Standardi ISO/IEC 17025:2017 është certifikatë akreditimi që i jepet vetëm laboratorëve të testimit dhe kalibrimit, të cilët kryejnë analiza dhe matje sipas standardeve ndërkombëtare. Ky standard nuk aplikohet për operatorët ekonomikë që nuk janë laboratorë, prandaj është praktikë e zakonshme që operatorët të mbështeten në laboratorë të akredituar, me të cilët kanë marrëveshje bashkëpunimi. Në përputhje me praktikat e prokurimit publik dhe standardet ndërkombëtare, kërkesa për ISO/IEC 17025 konsiderohet e përmbushur nëse operatori ekonomik dëshmon se testimet apo analizat përkatëse kryhen përmes një laboratorit të akredituar sipas këtij standardi.

Ne kemi dorëzuar certifikatën e laboratorit të akredituar, si dhe kontratën e bashkëpunimit që vërteton lidhjen ligjore dhe operative ndërmjet kompanisë sonë dhe laboratorit në fjalë. Prandaj, kriteri i parashtruar në DT është plotësuar në tërësi, pasi qëllimi i kërkesës për ISO/IEC 17025 është garantimi i cilësisë dhe saktësisë së testimeve laboratorike, e cila në këtë rast është siguruar përmes laboratorit të certifikuar me të cilin ne bashkëpunojmë.

Në lidhje me pretendimin 5: Arsyeja e refuzimit të ofertës sonë është si vijon: GOE lidhur me pikën nr. 8. Gjashtë (6) punëtorë të certifikuar për largimin e materialeve me azbest sipas normave ndërkombëtare. Dëshmia: 8. Të dëshmohet me kopje të certifikatave, CV, certifikata, kontrata e punës me punëdhënësin ose marrëveshja mbi angazhimin për këtë projekt, si dhe referenca për punët e mëparshme në lëmin e kërkuar të lëshuara nga punëdhënësi. GOE për këtë pikë nuk ka ofruar asnjë CV sipas kërkesës për këtë pikë. Argumenti ynë: Kërkesa e parashtruar në Dosjen e Tenderit (DT): Gjashtë (6) punëtorë të certifikuar për largimin e materialeve me azbest sipas normave ndërkombëtare. Të dëshmohet me kopje të certifikatave, CV, certifikata, kontrata e punës me punëdhënësin ose marrëveshja mbi angazhimin për këtë projekt, si dhe referenca për punët e mëparshme në lëmin e kërkuar të lëshuara nga punëdhënësi. AK ka vlerësuar se GOE për këtë pikë nuk ka ofruar asnjë CV sipas kërkesës për këtë pikë. Ne nuk pajtohemi me këtë vlerësim, pasi kemi dorëzuar të gjitha dëshmitë thelbësore që provojnë përmbushjen e kërkesës, si në vijim: Në përputhje me kërkesat e DT-së, ne kemi dorëzuar për gjashtë (6) punëtorë: • kontratat e punës, • referencat për punët e mëparshme në lëmin e largimit të materialeve me azbest, • si dhe certifikatat përkatëse të trajnimit dhe certifikimit sipas normave ndërkombëtare. Sipas nenit 10 të Udhëzuesit Nr. 002/2024 për Plotësim-Ndryshimin e Udhëzuesit Nr. 001/2023 për Prokurimin Publik, në rastet kur një dokument i kërkuar si CV nuk është dorëzuar, Autoriteti Kontraktues ka të drejtë dhe detyrim të kërkojë informata sqaruese nga operatori ekonomik, nëse kriteri mund të vlerësohet i përmbushur përmes dokumenteve të tjera mbështetëse. Në këtë rast, dokumentet tona (certifikatat, kontratat e punës dhe referencat) përmbajnë të gjitha të dhënat që do të gjendeshin në CV, prandaj AK ka pasur mundësi ligjore të kërkojë vetëm sqarim shtesë, jo të eliminojë ofertën. Më tej, neni 59 dhe neni 72 i Ligjit për Prokurimin Publik (LPP) i japin AK-së kompetencën për të kërkuar sqarime ose plotësime në rastet kur dokumentacioni është i paplotë ose jo i qartë, në mënyrë që të sigurohet vlerësim i drejtë dhe proporcional i ofertave. Duke mos kërkuar sqarim apo plotësim të dokumenteve, AK ka vepruar në kundërshtim me këto dispozita ligjore dhe ka shkelur parimin e proporcionalitetit dhe trajtimit të barabartë të operatorëve ekonomikë. Mungesa e CV-ve nuk e bën automatikisht ofertën të papërgjegjshme, kur dokumente të tjera zyrtare provojnë qartazi se personeli i propozuar është i punësuar, ka përvojë dhe posedon certifikatat përkatëse. Në këtë mënyrë, Autoriteti Kontraktues ka shkelur nenin 72 dhe nenin 59 të Ligjit për Prokurimin Publik (LPP), të cilët parashohin të drejtën dhe detyrimin e AK-së për të kërkuar sqarime ose plotësime të dokumenteve në rast të paqartësive ose mungesës së dokumentacionit mbështetës, si dhe nenin 10 të Udhëzuesit Nr. 002/2024 për Prokurimin Publik, i cili përcakton qartë se në raste të tilla AK duhet të kërkojë informata sqaruese para se të marrë vendim për eliminim të ofertës.

Në lidhje me pretendimin 6: Arsyeja e refuzimit të ofertës sonë është si vijon: GOE lidhur me kërkesën nr. 10. Një (1) inxhinier i makinerisë me së paku tre (3) vjet përvojë pune, i certifikuar për punë në lokalitetet me azbest. Dëshmia e kërkuar: CV, diplomë, certifikata, kontrata e punës me punëdhënësin ose marrëveshja mbi angazhimin për këtë projekt, si dhe referenca për punët e mëparshme në lëmin e kërkuar të lëshuara nga punëdhënësi. GOE për këtë pikë ka paraqitur një Bachelor që është në kundërshtim, si dhe i mungon CV-ja, andaj edhe për këtë pikë është e papërgjegjshme. Argumenti ynë: Kërkesa e parashtruar në DT: Një (1) inxhinier i makinerisë me së paku tre (3) vite përvojë pune. Dëshmia e kërkuar: Diploma universitare, kontrata e punës, CV

dhe referenca që vërtetojnë përvojën e punës. AK ka vlerësuar se oferta është e papërgjegjshme, me arsyetimin se diploma “Bachelor i Shkencave në Makineri” nuk dëshmon që kandidati është “Inxhinier i Makinerisë” dhe se ka munguar CV-ja. Ne nuk pajtohemi me këtë vlerësim, për arsye të mëposhtme: Diploma Bachelor në Shkenca të Makinerisë është dokument zyrtar që konfirmon kualifikimin profesional si inxhinier i makinerisë, sipas sistemit arsimor në Kosovë dhe standardeve ndërkombëtare. Ky nivel i arsimit (Bachelor) i jep automatikisht titullin profesional “Inxhinier” dhe përmbush kërkesën për kualifikim profesional të parashtruar në DT. Mungesa e CV-së nuk mund të shërbejë si bazë për eliminim, sipas nenit 10 të Udhëzuesit Nr. 002/2024 për Plotësim-Ndryshimin e Udhëzuesit Nr. 001/2023 për Prokurimin Publik. Në rastet kur një dokument i kërkuar si CV nuk është dorëzuar, Autoriteti Kontraktues ka të drejtë dhe detyrim të kërkojë informata sqaruese nga operatori ekonomik, nëse kriteri mund të vlerësohet i përmbushur përmes dokumenteve të tjera mbështetëse. Në këtë rast, dokumentet tona (certifikatat, kontratat e punës dhe referencat) përmbajnë të gjitha të dhënat që do të gjendeshin në CV, prandaj AK ka pasur mundësi ligjore të kërkojë vetëm sqarim shtesë, jo të eliminojë ofertën. Çdo vlerësim që dorëzimi i diplomës Bachelor dhe dokumenteve mbështetëse nuk përmbush kriterin e inxhinierit është interpretim i pasaktë i kërkesës së DT-së dhe i pabazuar në praktikën ligjore dhe arsimore. Përfundimisht, kërkojmë që Autoriteti Kontraktues të rishqyrtojë vendimin, duke marrë parasysh:– diplomën Bachelor që dëshmon kualifikimin profesional,– referencat dhe kontratat e punës që dëshmojnë përvojën e kërkuar,– mungesën e CV-së si faktor që mund të zgjidhet me sqarim shtesë sipas nenit 10 të Udhëzuesit Nr. 002/2024, dhe të pranojë se kriteri për inxhinierin e makinerisë është plotësuar.

Në lidhje me pretendimin 7: Arsyeja e refuzimit të ofertës sonë është si vijon: Nuk janë ofruar CV-të për 6 punëtorët e certifikuar për largimin e materialeve me azbest, ashtu siç kërkohet. Argumenti ynë Vlerësimi i AK-së: Nuk janë ofruar CV-të për 6 punëtorët e certifikuar për largimin e materialeve me azbest, ashtu siç kërkohet. Ky është përsëritje e pretendimit të bërë më lart (pika 5). Siç është arsyetuar, dokumentet e dorëzuara (certifikatat, kontratat e punës dhe referencat) përmbajnë të gjitha të dhënat që do të gjendeshin në CV, dhe sipas nenit 10 të Udhëzuesit Nr. 002/2024, AK kishte mundësi ligjore të kërkojë sqarim shtesë, jo të eliminojë ofertën. Për këtë arsye, oferta për këtë pikë është plotësuese dhe e përgjegjshme, dhe vendimi i AK-së për eliminim është i paarsyeshëm dhe i pabazuar ligjërisht.

Në lidhje me pretendimin 8: Arsyeja e refuzimit të ofertës sonë është si vijon: Për kërkesën për një inxhinier të makinerisë, është dorëzuar vetëm diploma e një Bachelor-i, pa CV dhe certifikatë, dhe diploma nuk është në përputhje me kërkesën. Kjo e bën ofertën të papërgjegjshme për këtë pikë. Argumenti ynë Vlerësimi i AK-së: Për kërkesën për një inxhinier të makinerisë, është dorëzuar vetëm diploma e një Bachelor-i, pa CV dhe certifikatë, dhe diploma nuk është në përputhje me kërkesën. Kjo e bën ofertën të papërgjegjshme për këtë pikë. Ky është përsëritje e pretendimit të bërë më lart (pika 6). Siç është shpjeguar, diploma Bachelor në Shkenca të Makinerisë është dëshmi e plotë e kualifikimit profesional si inxhinier i makinerisë, dhe dokumentet mbështetëse që kemi dorëzuar (referencat dhe kontrata e punës) vërtetojnë përvojën e kërkuar. Sipas nenit 10 të Udhëzuesit Nr. 002/2024, në rast se një dokument i kërkuar si CV mungon, AK ka detyrimin të kërkojë informata sqaruese, jo të eliminojë ofertën. Përveç kësaj, diploma dhe dokumentet mbështetëse përmbajnë të gjitha të dhënat që do të gjendeshin në CV, prandaj oferta është e përgjegjshme për këtë pikë. Ky vlerësim përbën shkelje të drejtpërdrejtë të nenit 59 dhe nenit 72 të LPP-së, nenit 25 të Rregullores së Prokurimit Publik, si dhe nenit 10 të Udhëzuesit Nr. 002/2024 për Prokurimin Publik, duke cenuar parimet e barazisë, proporcionalitetit dhe trajtimit të drejtë të operatorëve ekonomikë.

Pretendimi 9 – Shkelje e nenit 1, 6, 7 dhe 60 të LPP-së Në lidhje me aktivitetin e prokurimit të lartcekur, Autoriteti Kontraktues ka marrë vendim për anulimin e aktivitetit të prokurimit, ndonëse kompania jonë ka ofruar ofertë të plotë, të përgjegjshme dhe në përputhje me kërkesat e dosjes së tenderit, në vlerë prej 30,220 €. Vendimi i Autoritetit Kontraktues është i pabazuar në Ligjin për Prokurimin Publik (LPP) dhe bie në kundërshtim me parimet themelore të prokurimit publik, të përcaktuara në nenet 1, 6, 7 dhe 60 të LPP-së. 1. Shkelje e nenit 1 të LPP-së – Qëllimi Neni 1 i LPP-së përcakton se qëllimi i ligjit është: “Të sigurojë që prokurimi publik të zhvillohet në mënyrë transparente, jodiskriminuese dhe të arrihet vlera më e mirë për parane publike.” Në këtë rast, anulimi i aktivitetit të prokurimit, në mungesë të ndonjë arsye të ligjshme për mospërgjegjshmëri të ofertës sonë, përbën shkelje të këtij neni, pasi AK ka dështuar të sigurojë vlerën më të mirë për parane publike dhe ka vepruar në mënyrë të paarsyeshme dhe joproporcionale. 2. Shkelje e nenit 6 të LPP-së – Ekuivalenciteti dhe Efikasiteti Neni 6 i LPP-së përcakton se: “Autoritetet kontraktuese janë të obliguara të sigurojnë përdorimin sa më ekonomik, efikas dhe efektiv të fondeve publike.” Duke refuzuar ofertën tonë të përgjegjshme dhe më të favorshme ekonomikisht, AK ka vepruar në kundërshtim me parimin e ekuivalencitetit, duke penguar përfundimin me sukses të procedurës. 3. Shkelje e nenit 7 të LPP-së – Barazia në Trajtim dhe Jo-Diskriminimi Neni 7 i LPP-së përcakton se: “Autoritetet kontraktuese do të trajtojnë në mënyrë të barabartë dhe jo diskriminuese të gjithë operatorët ekonomikë dhe do të veprojnë në mënyrë transparente.” Në këtë procedurë, AK nuk ka trajtuar në mënyrë të barabartë operatorët ekonomikë, pasi oferta jonë, ndonëse me çmimin më të ulët dhe me dokumentacion të plotë, është eliminuar pa arsye ligjore dhe pa u respektuar parimi i proporcionalitetit dhe transparencës. 4. Shkelje e nenit 60 të LPP-së – Kriteret për Dhënien e Kontratës Neni 60, paragrafi 1 i LPP-së përcakton: “Autoriteti kontraktues do t’ia japë kontratën publike operatorit ekonomik që ka dorëzuar tenderin e përgjegjshëm me çmimin më të ulët ose tenderin ekonomikisht më të favorshëm.” Në këtë aktivitet, kriteri i dhënies ka qenë sipas nenit 60.1.1 – “Tenderi i përgjegjshëm me çmimin më të ulët”. Duke qenë se oferta jonë përmbushte këtë kriter, anulimi i procedurës nga AK përbën shkelje të drejtpërdrejtë të nenit 60 të LPP-së, si dhe cenim të parimit të konkurrencës së ndershme dhe efikasitetit në përdorimin e fondeve publike.

Përgjigje në kërkesën për rishqyrtim: Operatori ekonomik “ASSET ING SH.P.K.” (tutje: parashtruesi) me datë 27.10.2025 ka paraqitur kërkesë për rishqyrtim kundër njoftimit mbi vendimin lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull “Largimi, trajtimi dhe deponimi i materialeve të rrezikshme në Kryeqytet”, me nr. të prokurimit 616-25-6217-5-2-1. Gjatë shqyrtimit paraprak të kërkesës për rishqyrtim të parashtruesit është gjetur se kërkesa është e lejuar dhe është parashtruar brenda afatit nga personi i autorizuar, si dhe nuk ekzistojnë pengesa tjera për të shqyrtuar kërkesën e parashtruesit. Në këtë mënyrë janë plotësuar kushtet për të vazhduar me shqyrtimin merit (in meritum) të kërkesës.

Pretendimet ankimore të parashtruesit:

Në lidhje me pretendimin 1: Neni 26.15 i Rregullores së Prokurimit Publik përcakton se: “Kur operatorët ekonomikë marrin pjesë si grup, grupi i operatorëve ekonomikë, së bashku me ofertën e tyre, duhet të ofrojnë një marrëveshje për themelimin e grupit, në të cilën anëtarët e grupit do t’i përcaktojnë të drejtat dhe përgjegjësitë, si dhe të gjitha veprimet procedurale që duhet t’i kryejë lideri i grupit në emër të grupit. Autoritetet kontraktuese duhet ta vendosin këtë kërkesë në Dosjen e Tenderit, si dhe formën standarde të marrëveshjes të hartuar dhe miratuar nga KRPP.” Përkundër faktit që Autoriteti Kontraktues nuk e ka vendosur këtë kërkesë në Dosjen e Tenderit, por vetëm ka ngarkuar një formë standarde të paplotë, e cila nuk është në përputhje të

plotë me versionin e miratuar nga KRPP, ne si Operator Ekonomik kemi shkarkuar formën standarde zyrtare nga platforma elektronike e KRPP-së dhe e kemi plotësuar në përputhje me nenin 26.15 të Rregullores së Prokurimit Publik. Prandaj, elimini i ofertës sonë për këtë pikë është i papranueshëm, pasi ne kemi përmbushur kërkesën në përputhje me dispozitat e Rregullores së Prokurimit Publik. Me këtë veprim, Autoriteti Kontraktues ka bërë shkelje të nenit 59 të Ligjit për Prokurimin Publik dhe nenit 26.15 të Rregullores së Prokurimit Publik. Bashkëngjitur gjeni Deklaratën e plotësuar për Themelimin e Grupit, deklaratë e dorëzuar me ofertë.

Në lidhje me pretendimin 2: Kërkesa e parashtruar në Dosjen e Tenderit (DT): Operatori ekonomik duhet të ketë pëlqim mjedisor për grumbullimin, ndarjen dhe trajtimin e mbeturinave të ndërtimit dhe rrënojave, të lëshuar nga Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës ose nga Komuna. Dëshmia e kërkuar: Operatori ekonomik duhet ta dëshmojë këtë me kopje të pëlqimit mjedisor për grumbullimin, ndarjen dhe trajtimin e mbeturinave të ndërtimit dhe rrënojave, të lëshuar nga Ministria ose nga Komuna përkatëse. AK ka refuzuar ofertën tonë me arsyetimin se leja e paraqitur nuk është e destinuar për azbest, sipas kërkesës dhe Aneksit 1 të njoftimit. Në Dosjen e Tenderit është kërkuar kopje e pëlqimit mjedisor për grumbullimin, ndarjen dhe trajtimin e mbeturinave të ndërtimit dhe rrënojave, dhe në përputhje me këtë kërkesë ne kemi dorëzuar pëlqimin mjedisor të lëshuar nga Komuna. Ky pëlqim mjedisor përmbush plotësisht kushtin e parashtruar në DT. Prandaj, elimini i ofertës sonë për këtë pikë është i papranueshëm, pasi ne kemi përmbushur kërkesën në përputhje me kërkesën e parashtruar në DT. Me këtë veprim, Autoriteti Kontraktues ka bërë shkelje të nenit 59 të Ligjit për Prokurimin Publik. Bashkëngjitur gjeni pëlqimin mjedisor të lëshuar nga Komuna.

Në lidhje me pretendimin 3: Kërkesa e parashtruar në Dosjen e Tenderit (DT): Operatori ekonomik duhet të ofrojë dëshmi të pranueshme se qarkullimi vjetor i operatorit ekonomik ose i grupit të operatorëve ekonomikë gjatë tre (3) viteve të fundit (për tri vitet së bashku) të ketë qenë në vlerë jo më pak se 100,000.00 €. Dëshmia e kërkuar: Deklaratat tatimore vjetore të dorëzuara në Administratën Tatimore të Kosovës për tri vitet e fundit. AK ka vlerësuar se jemi të papërgjegjshëm, me arsyetimin se në ofertë është dorëzuar një deklaratë tatimore në gjuhën maqedonase, duke e konsideruar këtë dokument si jo të vlefshëm dhe të papranueshëm për këtë pikë të DT-së. Ne nuk e kontestojmë vlefshmërinë e nenit 13.4 të Ligjit për Prokurimin Publik (LPP), por konsiderojmë se interpretimi dhe zbatimi i tij në këtë rast nga AK është i gabuar dhe i paarsyeshëm, për arsyet e mëposhtme:

Në lidhje me pretendimin 4: Kërkesa e parashtruar në Dosjen e Tenderit (DT): Operatori ekonomik duhet të posedojë certifikimet dhe t'i prezantojë certifikatat EN ISO 9001, EN ISO 14001, BS ISO 45001 dhe ISO/IEC 17025.

Dëshmia e kërkuar: Certifikatat. Arsyetimi i Autoritetit Kontraktues (AK): OE për këtë pikë nuk ka ofruar dëshmi – certifikatë për ISO/IEC 17025. Ne nuk pajtohemi me këtë konstatim të AK-së, për arsyet e mëposhtme: Ne kemi dorëzuar certifikatën ISO/IEC 17025 në ofertë. Kjo certifikatë është lëshuar për laboratorin me të cilin kemi kontratë bashkëpunimi. Standardi ISO/IEC 17025:2017 është certifikatë akreditimi që u jepet vetëm laboratorëve të testimit dhe kalibrimit, të cilët kryejnë matje dhe analiza sipas standardeve ndërkombëtare. Ky standard nuk aplikohet për operatorët ekonomikë që nuk janë laboratorë, prandaj është praktikë e zakonshme që operatorët të mbështeten në laboratorë të akredituar, me të cilët kanë marrëveshje bashkëpunimi. Në përputhje me praktikat e prokurimit publik dhe standardet ndërkombëtare, kërkesa për ISO/IEC 17025 konsiderohet e përmbushur nëse operatori ekonomik dëshmon se testimet apo

analizat përkatëse kryhen përmes një laboratorit të akredituar sipas këtij standardi. Ne kemi dorëzuar certifikatën e laboratorit të akredituar, si dhe kontratën e bashkëpunimit që vërteton lidhjen ligjore dhe operative ndërmjet kompanisë sonë dhe laboratorit në fjalë. Prandaj, kriteri i parashtruar në DT: “Operatori ekonomik duhet të posedojë laborator të akredituar sipas standardeve ISO/IEC 17025 dhe metodë të akredituar për analizë të azbestit”, përkatësisht “duhet të dëshmojë se ka laborator apo marrëveshje me një laborator të akredituar, si dhe kopjen e licencës”, është plotësuar në tërësi, pasi qëllimi i kërkesës për ISO/IEC 17025 është garantimi i cilësisë dhe saktësisë së testimeve laboratorike, e cila në këtë rast është siguruar përmes laboratorit të certifikuar me të cilin ne kemi marrëveshje bashkëpunimi.

Në lidhje me pretendimin 5:Kërkesa e parashtruar në Dosjen e Tenderit (DT): Gjashtë (6) punëtorë të certifikuar për largimin e materialeve me azbest sipas normave ndërkombëtare.Të dëshmohet me kopje të certifikatave, CV, certifikata, kontrata e punës me punëdhënësin ose marrëveshja mbi angazhimin për këtë projekt, si dhe referenca për punët e mëparshme në lëmin e kërkuar të lëshuara nga punëdhënësi.AK ka vlerësuar se GOE për këtë pikë nuk ka ofruar asnjë CV sipas kërkesës për këtë pikë.Ne nuk pajtohemi me këtë vlerësim, pasi kemi dorëzuar të gjitha dëshmitë thelbësore që provojnë përmbushjen e kërkesës, si në vijim:Në përputhje me kërkesat e DT-së, ne kemi dorëzuar për gjashtë (6) punëtorë:kontratat e punës,referencat për punët e mëparshme në fushën e largimit të materialeve me azbest,si dhe certifikatat përkatëse të trajnimit dhe certifikimit sipas normave ndërkombëtare.Sipas nenit 10 të Udhëzuesit Nr. 002/2024 për Plotësim-Ndryshimin e Udhëzuesit Nr. 001/2023 për Prokurimin Publik, në rastet kur një dokument i kërkuar si CV nuk është dorëzuar, Autoriteti Kontraktues ka të drejtë dhe detyrim të kërkojë informata sqaruese nga operatori ekonomik, nëse kriteri mund të vlerësohet i përmbushur përmes dokumenteve të tjera mbështetëse.Në këtë rast, dokumentet tona (certifikatat, kontratat e punës dhe referencat) përmbajnë të gjitha të dhënat që do të gjendeshin në CV, prandaj AK ka pasur mundësi ligjore të kërkojë vetëm sqarim shtesë, jo të eliminojë ofertën.Më tej, neni 59 dhe neni 72 i Ligjit për Prokurimin Publik (LPP) i japin AK-së kompetencën për të kërkuar sqarime ose plotësime në rastet kur dokumentacioni është i paplotë ose jo i qartë, në mënyrë që të sigurohet vlerësimi i drejtë dhe proporcional i ofertave.Duke mos vepruar në përputhje me këto dispozita ligjore, AK ka shkelur parimet e proporcionalitetit dhe trajtimit të barabartë të operatorëve ekonomikë.Mungesa e CV-ve nuk e bën automatikisht ofertën të papërgjegjshme kur dokumente të tjera zyrtare provojnë qartazi se personeli i propozuar është i kualifikuar, ka përvojë dhe posedon certifikata përkatëse.Në këtë rast, Autoriteti Kontraktues ka shkelur nenin 72 të Ligjit për Prokurimin Publik (LPP), i cili parashikon të drejtat dhe detyrimin e AK-së për të kërkuar sqarime ose plotësime të dokumenteve në rast të paqartësive ose mungesës së dokumentacionit mbështetës, si dhe Udhëzimin Nr. 002/2024 për Prokurimin Publik, i cili përcakton qartë se në raste të tilla AK duhet të kërkojë informata sqaruese para se të marrë vendim për eliminimin e ofertës.

Në lidhje me pretendimin 6:Kërkesa e parashtruar në DT: Një (1) teknik i makinerisë me së paku tre (3) vite përvojë pune.Dëshmia e kërkuar: Diplomë universitare, kontrata pune, CV dhe referenca që vërtetojnë përvojën e punës.AK ka vlerësuar se oferta është e papërgjegjshme, me arsyetimin se diploma “Bachelor i Shkencave në Makineri” nuk është në përputhje me kërkesën “Teknik i Makinerisë” dhe se ka munguar CV-ja.Ne nuk pajtohemi me këtë vlerësim, për arsyet e mëposhtme:Diploma Bachelor i Shkencave në Makineri është dokument zyrtar që konfirmon kualifikimin profesional si teknik i makinerisë, sipas sistemit arsimor në Kosovë dhe standardeve ndërkombëtare. Ky nivel arsimor (Bachelor) i jep statusin profesional “teknik i makinerisë” dhe përmbush kërkesat për kualifikim profesional të parashtruara në DT.AK nuk mund të refuzojë ofertën për mungesë të CV-së sipas nenit 10 të Udhëzimit Nr. 002/2024 për Plotësim-

Ndryshimin e Udhëzimit Nr. 001/2023 për Prokurimin Publik. Në rastet kur një dokument i kërkuar si CV mungon, Autoriteti Kontraktues ka të drejtë dhe detyrim të kërkojë informata sqaruese nga operatori ekonomik, nëse kriteri mund të vlerësohet i përmbushur përmes dokumenteve të tjera mbështetëse. Çdo vlerësim që refuzon diplomën Bachelor dhe dokumentet mbështetëse, duke mos i pranuar si përmbushje të kriterit të teknikës, përbën interpretim të gabuar të kërkesave të DT-së dhe është në kundërshtim me praktikën ligjore dhe arsimore. Përfundimisht, kërkojmë që Autoriteti Kontraktues ta rishqyrtojë vendimin, duke marrë parasysh: Diplomat Bachelor si dëshmi kualifikimi profesional; Referencat dhe kontratat e punës që dëshmojnë përvojën e kërkuar; Mungesën e CV-së si faktor që mund të zgjidhet me sqarim shtesë, sipas nenit 10 të Udhëzimit Nr. 002/2024, dhe të pranojë se kriteri për teknikun e makinerisë është plotësuar.

Në lidhje me pretendimin 7: Vlerësimi i AK-së bazohet në mungesën e CV-ve për gjashtë punëtorë të certifikuar për largimin e materialeve me azbest, ashtu siç kërkohet. Ky është përsëritje e pretendimit të bërë më lart (pika 5). Siç është arsyetuar, dokumentet e dorëzuara (certifikatat, kontratat e punës dhe referencat) përmbajnë të gjitha të dhënat që do të gjendeshin në CV, dhe sipas nenit 10 të Udhëzimit Nr. 002/2024, AK kishte mundësi ligjore të kërkonte sqarime shtesë, jo të eliminonte ofertën. Për këtë arsye, oferta për këtë pikë është plotësuese dhe e përgjegjshme, dhe qëndrimi i AK-së për eliminim është i paarsyeshëm dhe i pambështetur ligjërisht.

Në lidhje me pretendimin 8: Vlerësimi i AK-së: Për kriterin për një inxhinier të makinerisë është dorëzuar vetëm diploma e një Bachelor-i, pa CV dhe certifikatë, dhe diploma nuk është në përputhje me kërkesën, gjë që e bën ofertën të papërgjegjshme për këtë pikë. Ky është përsëritje e pretendimit të bërë më lart (pika 6). Siç është shpjeguar, diploma Bachelor në Shkenca të Makinerisë është dëshmi e plotë e kualifikimit profesional si inxhinier i makinerisë, ndërsa dokumentet mbështetëse që kemi dorëzuar (referencat dhe kontratat e punës) vërtetojnë përvojën e kërkuar. Sipas nenit 10 të Udhëzimit Nr. 002/2024, në rast se një dokument i kërkuar si CV mungon, AK është i obliguar të kërkojë informata sqaruese nga operatori ekonomik. Përveç kësaj, diploma dhe dokumentet mbështetëse përmbajnë të gjitha të dhënat që do të gjendeshin në CV, prandaj oferta për këtë pikë është e përgjegjshme. Ky vlerësim përbën shkelje të drejtpërdrejtë të neneve 51, 52 dhe nenit 35 të Rregullores së Prokurimit Publik, si dhe nenit 10 të Udhëzimit Nr. 002/2024 për Prokurimin Publik, duke cenuar parimet e barazisë, proporcionalitetit dhe trajtimit të drejtë të operatorëve ekonomikë.

Lidhur me pretendimet ankimore të parashtruesit sa i përket arsyeve eliminuese të prezantuara në letrën standarde, përmes së cilës parashtruesi është eliminuar si i papërgjegjshëm, është gjetur që arsyet e evidentuara nga komisioni vlerësues për eliminimin e parashtruesit si i papërgjegjshëm janë të sakta, të matshme dhe të ligjshme. Rrjedhimisht, është gjetur se eliminimi i parashtruesit është bërë në mënyrë të drejtë.

Nga sa u tha më sipër, është gjetur se parashtruesi nuk ka paraqitur argumente të qëndrueshme për të mbështetur pretendimet e tij. Prandaj, kërkesa për rishqyrtim e parashtruesit është refuzuar si e pabazuar në tërësi.

Duke u mbështetur te neni 111 paragrafi 5 lidhur me nenet 113 dhe 114 të LPP, Organi Shqyrtues i Prokurimit me datë 20.11.2025 ka autorizuar ekspertin shqyrtues për të bërë shqyrtimin fillestar të dosjes dhe pretendimeve sipas ankesës me nr. 2025/1118, ndërsa me datë 01.12.2025 është dorëzuar raporti i ekspertit shqyrtues me nr. 2025/1118, me rekomandimet si në

vijim: Duke u bazuar në sqarimet e lartpërmendura, eksperti shqyrtues i propozon panelit shqyrtues që ankesa e OE ankues aprovohet si pjesërisht e bazuar dhe të mbetet në fuqi vendimi i AKRaportin e ekspertizës e kanë pranuar me rregull të gjitha palët procedurale. AK është pajtuar rekomandimet e raportit të ekspertit shqyrtues, ndërsa OE nuk është pajtuar lidhur me raportin e ekspertit shqyrtues.

Paneli shqyrtues ka vlerësuar se janë plotësuar kushtet për të vendosur mbi këtë lëndë pa seancë dëgjimore në kuptim të nenit 24 paragrafi 1 të Rregullores së Punës së OSHP-së duke marr parasysh që pretendimet e palëve dhe parashtrësat e tyre, provat si dhe raporti i ekspertit shqyrtues ofrojnë të dhëna të mjaftueshme për të vendosur në aspektin merititor lidhur me rastin.

- Administrimi dhe vlerësimi i provave –

Me qëllim të vërtetimit të drejtë gjendjes faktike, paneli shqyrtues ka administruar si prova Raportin e Ekspertit Shqyrtues, parashtrësat dhe dokumentet e operatorit ekonomik ankues, shkresat dhe dokumentet e Autoritetit Kontraktues, dokumentet relevante lidhur me aktivitetin e prokurimit si dhe të gjitha provat që janë propozuar nga palët procedurale.

Lidhur me pretendimet e OE ASSET ING SH.P.K., eksperti shqyrtues përmes raportit nr. 2025/1118 ka vlerësuar si në vijim:

Aktiviteti i prokurimit me titull: “Largimi, trajtimi dhe deponimi i materialeve te rrezikshme ne Kryeqytet” me nr. të prokurimit: "616-25-6217-5-2-1", iniciuar nga Autoriteti Kontraktues (AK) – KUVENDI I KOMUNES SE PRISHTINES, procedurë e hapur, lloji i kontratës punë, kriteri çmimi më i ulët i përgjegjshëm.

Ankesa është e parashtruar kundër anulimit të aktivitetit të prokurimit. OE ankues është eliminuar me arsyetimin:

Arsyetim: Tenderi juaj është i refuzuar për këto arsye: 1. GOE për kërkesën e detyrueshme “Deklarata për themelimin e grupit GOE”, kjo ofertë është e papërgjegjshme sepse janë ngarkuar dy deklarata të ndryshme, me ndarje të ndryshme të përgjegjësi. Anëtar i konzorciumit EKO-TERM DOO ka paraqitur një deklaratë të veçantë ku ka deklaruar se është pjesëmarrës me OE ASSET ING SHPK si lider 80% pjesëmarrje, ndërsa vetë me 20% pjesëmarrje ne ekzekutimin e punimeve, ndërkohë që në deklaratën tjetër janë paraqitur përqindje të ndryshme dhe janë shtuar edhe dy OE të tjerë. 2. Nuk është dëshmuar leja/pëlqimi mjedisor për grumbullimin, ndarjen dhe trajtimin e mbeturinave të ndërtimit dhe rrethojave, të lëshuar nga Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës ose nga Komuna. Leja e paraqitur nuk është e destinuar për azbest sipas kërkesës dhe aneksit 1 të detyrueshëm. 3. GOE lidhur me kërkesën nr. Te DT 3. A. Operatori ekonomik duhet të ofrojë dëshmi të pranueshme se qarkullimi vjetor i OE ose grupit të OE gjatë 3 viteve të fundit (për tri vitet bashkë) ka qenë në vlerë jo më pak se 100,000.00 euro, dëshmia e kërkuar: a. Deklarata tatimore vjetore të dorëzuara në Administratën Tatimore të Kosovës (për tri vitet e fundit), GOE për këtë pikë është e pa përgjegjshme sepse me ofertën e tij ka dorëzuar një deklaratë në gjuhën Maqedonas dhe për këtë pikë është e pa përgjegjshme dhe jo bindëse. 4. GOE lidhur me kërkesën nr.4 Operatori Ekonomik duhet të posedoj certifikim, ti prezantoj certifikatën EN-ISO -9001, EN-ISO-14001, BS ISO -45001 dhe ISO IEC -17025. Dëshmia:4. Certifikatën GOE për këtë pikë nuk ka ofruar certifikatën për ISO IEC -17025. 5. GOE lidhur me pikën nr.8 Gjashtë (6) punëtor të certifikuar për largimin e materialeve me azbest sipas normave ndërkombëtare. Dëshmia: Të dëshmohet me kopje të certifikatave CV, certifikata, kontrata e punës me punëdhënësin ose marrëveshja mbi angazhimin

për këtë projekt, si dhe Referenca për punët e mëparshme në lëmine e kërkuar të lëshuar nga punëdhënësi, GOE për këtë pikë nuk ka ofruar asnjë CV sipas kërkesës për këtë pikë. 6. GOE lidhur me kërkesën nr.10 Një (1) inxhinier i makinerisë me së paku tre vjet përvojë pune, i certifikuar për punë në lokalitetet me azbest. Dëshmia e kërkuar: 10. Dëshmi: CV, diploma, certifikata, Kontrata e punës me punëdhënësin ose marrëveshja mbi angazhimin për këtë projekt, si dhe referenca për punët e mëparshme në lëmine e kërkuar të lëshuar nga punëdhënësi, edhe për këtë pikë është i pa përgjegjshëm. 7. Nuk janë ofruar CV-të për 6 punëtor të certifikuar për largimin e materialeve me azbest, ashtu siç kërkohet. 8. Për kërkesën për një inxhinier të makinerisë, është dorëzuar vetëm diploma e një Bachelor-i, pa CV dhe certifikatë, dhe diploma nuk është në përputhje me kërkesën. Kjo e bënë ofertën të papërgjegjshme për këtë pikë. Tutje, OE ankues pas refuzimit të kërkesës për rishqyrtim nga AK, i njëjti parashtroi ankesë pranë OSHP-së, duke pretenduar se AK nuk ka vlerësuar drejte ofertat dhe se gjatë vlerësimit shkelë Ligjin e Prokurimit Publik përkatësisht nenet: 1,6,7,59,56,60,72, nenin 25.15 të Rregullores për prokurim publik dhe nenin 10 të Udhëzuesit nr. 002/2024.

OE ankues ka parashtuar pretendime ankimore kundër arsyes së eliminimit të përmendura si më lartë.

Përgjigje në pretendimet ankimore të OE ankues:

Ekspertja shqyrtuese pas analizimit dhe shqyrtimit të shkresave të lëndës, lidhur me arsyen e parë të eliminimit sqaron se, në ofertën e OE ankues gjendet marrëveshja e konzorciumit, e cila është e plotësuar më katër anëtar të konzorciumit sipas përqindjes 70%,10%,10%,10%, e cila përkon me formularin e dorëzimit të tenderit, mirëpo gjithashtu gjendet edhe një marrëveshje e cila është e plotësuar për dy anëtar të konzorciumit, me përqindje 80% dhe 20%, mirëpo meqë kjo marrëveshje nuk është e plotësuar e tëra, nuk ka as nënshkrim, vulë nga lideri, vërehet se është marrëveshje e futur gabimisht e cila ka qenë dokument gjatë përgatitjeve për dorëzim të tenderit. Andaj duke qenë se marrëveshja e nënshkruar dhe vulosur me katër anëtar, përkon me formularin e dorëzimit të tenderit, e cila ka të listuar anëtarët sipas renditjes, atëherë si e tillë kjo arsye e eliminimit sipas ekspertës shqyrtuese nuk qëndron. Pretendimi i OE ankues gjendet i bazuar.

Tutje, pretendimi i dytë lidhur me arsyen e dytë të eliminimit të OE ankues, ekspertja shqyrtuese sqaron se, AK në dosje të tenderit ka kërkuar: 2. Operatori ekonomik duhet te kete pelqim mjedisor per Grumbullimin, Ndarjen, Trajtimin e Meturinave të Nertimit dhe Rrënojave nga Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësiror dhe Infrastruktures opo nga Komuna Dëshmia e kërkuar: 2. OE duhet te deshmoj me kopje te pelqimit mjedisor per Grumbullimin, Ndarjen, Trajtimin e Meturinave të Nertimit dhe Rrënojave te leshuar nga Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësiror dhe Infrastruktures opo nga komuna

Kurse në ofertën e OE ankues gjenden: -Vendimi nga anëtari i konzorciumit për Leje mjedisore komunale për deponimin e përkohshëm të mbeturinave të vëllimshme dhe bartja e tyre deri në deponi. Vendimi tjetër nga anëtari tjetër i konzorciumit për leje mjedisore komunale për deponimin e përkohshëm dhe trajtimin e mbeturinave ndërtimore, -Si dhe leja nga anëtari i konzorciumit nga Maqedonia, leje për kryerjen e aktivitetit të mbledhjes dhe transportimit të mbeturinave të rrezikshme, e cila leje është e përkthyer në gjuhën Angleze, që mund të përdoret si dëshmi shtesë në kapacitetin e ofertuesit lidhur me këtë lëmi dhe si e tillë bazuar në lejet komunale, të ofruara nga anëtarët e konzorciumit, konsiderohet se e plotësojnë kërkesën e AK-së sipas dosjes së tenderit, përkundër që vet titulli dhe paramasa është e dedikuar për materialet e

rrezikshme Azbest, mirëpo në kërkesën dy të DT-së nuk është e përmendur specifikisht azbesti. Andaj pretendimi i OE ankues gjendet i bazuar.

Pretendimi i tretë: Ekspertja shqyrtuese, lidhur me këtë pretendim, sqaron se dokumentet e kërkuara në dosjen e tenderit (nenet 8.1 dhe 8.2) janë paraqitur nga një anëtar i konzorciumit me shtetësi maqedonase. Për pasojë, raporti dhe dokumentacioni janë në gjuhën maqedonase, gjë që ka penguar vlerësimin e ofertës. Megjithatë, operatori ekonomik ankues, as në kërkesën për rishqyrtim dhe as në ankesë, nuk ka dëshmuar se këto dokumente janë lëshuar nga Administrata Tatimore e vendit, duke i bashkëngjitur të përkthyer, andaj meqë i njëjti nuk ka provuar me fakte dhe argumente pretendimin e ngritur, atëherë si e tillë nuk gjendet i bazuar.

Pretendimi i katërt: Ekspertja shqyrtuese lidhur me kërkesën për ISO standardin nr. ISO IEC - 17025, gjendet marrëveshja me laboratorin sipas kërkesës në dosje të tenderit nr. 5 e cila dëshmohet me ISO standardin e kërkuar 17025. Andaj konsiderohet i plotësuar. Pretendimi i bazuar.

Pretendimi i pestë dhe shtatë janë të lidhur si arsye e njëjtë e eliminimit, për gjashtë punëtorët të cilëve ju mungon CV, ekspertja shqyrtuese konsideron se CV mund të plotësohet si dëshmi, mirëpo në rastin konkret OE ankues pretendimin ankimor nuk e provon me fakte dhe argumente duke bashkëngjitur të paktën me ankesë dokumentet e munguara, atëherë si e tillë nuk gjenden të bazuara.

Pretendimi i gjashtë dhe tetë janë të lidhura si arsye e njëjtë e eliminimit, për mungesë të dëshmive të inxhinierit të makinerisë, të cilat ekspertja shqyrtuese sa i përket mungesës së CV, bazuar në udhëzuesin e prokurimit publik mund të kërkohej, mirëpo në rastin konkret OE ankues pretendimin ankimor nuk e provon me fakte dhe argumente duke bashkëngjitur të paktën me ankesë dokumentet e munguara, atëherë si e tillë nuk gjenden të bazuara. Pretendimi nuk qëndron.

Paneli konstatoi se nuk ekzistojnë elementet për parandalim të konfliktit të interesit, siç kërkohej në kuptim të nenit 11 të Rregullores për Punën e OSHP, lidhur me paragrafin 1.75, të nenit 4 të LPP dhe njëherësh analizoi të gjitha shkresat e kësaj lënde, përfshirë të gjitha aktet dhe veprimet e palëve dhe konsideroi se nuk ka nevojë të konvokohet seanca dëgjimore me palë, përderisa parashtrësat e palëve dhe veprimet e tyre, përbëjnë bazë të mjaftueshme për të vendosur në aspektin meritore sikurse parashihet me paragrafin 1, të nenit 24 të Rregullores së Punës së OSHP, dhe se nuk ka nevojë të kërkohej nga autoriteti kontraktues dhe/ose parashtrësi i ankesës që të sigurojë informata dhe/ose shpjegime shtesë, në kuptim të paragrafit 3, të nenit 116 të LPP.

- Gjetjet e Panelit Shqyrtues –

Paneli Shqyrtues duke i analizuar shkresat e kësaj lënde dhe veprimet e ndërmarra nga palët, deklaratat e tyre dhe provat e administruara gjatë rrjedhës së këtij aktivitetit të prokurimit, konsideron se gjetjet e ekspertit shqyrtues mendimet e tij janë të pranueshme dhe se Paneli Shqyrtues me të drejtë e mori në konsideratë Raportin e tij me rastin e vendosjes.

Në rastin konkret nga raporti i ekspertit shqyrtues, dëshmitë e prezantuara nga operatori ekonomik ankues, dokumentet e dosjes së tenderit si dhe nga provat tjera të rastit është gjetur se

pretendimet ankimore janë pjesërisht të bazuara. Duke u bazuar në gjendjen faktike të konstatuar si më sipër, Paneli Shqyrtues i ka falur besimin e plotë konstatimeve dhe rekomandimeve në raportin e ekspertit shqyrtues. Rrjedhimisht Paneli Shqyrtues ka gjetur se pretendimet e operatorit ekonomik ankues janë pjesërisht të bazuara.

Paneli shqyrtues pas administrimit dhe vlerësimit të provave, konstatimit të plotë të gjendjes faktike, duke u mbështetur në LPP si ligj material të zbatueshëm, pas shqyrtimit të pretendimeve ankimore, duke marrë parasysh të gjitha shkresat e lëndës dhe rekomandimet e ekspertit, ka gjetur se ankesa e Operatorit Ekonomik duhet të aprovohet si pjesërisht e bazuar. Rrjedhimisht Paneli Shqyrtues ka vendosur të mbetet në fuqi Njoftimi mbi Vendimin të Autoritetit Kontraktues KUVENDI I KOMUNES SE PRISHTINES, lidhur me aktivitetin e prokurimit “Largimi, trajtimi dhe deponimi i materialeve të rrezikshme në Kryeqytet” me numër të prokurimit 616-25-6217-5-2-1. pasi që nuk ekzistojnë argumente të mjaftueshme ligjore për të urdhëruar AK që të kthejë aktivitetin e prokurimit në rivlerësim, për arsyet e elaboruara nga eksperti si më sipër në këtë vendim dhe të aprovuara nga paneli shqyrtues.

Panelit Shqyrtues ka vendosur në përputhje me kompetencat ligjore në kuptim të nenit 104 paragrafi 1 lidhur me nenin 103, nenin 105 dhe nenin 117 të LPP për zbatimin e procedurës së shqyrtimit të prokurimit në mënyrë të shpejtë, të drejtë, pa diskriminim, me qëllim të zgjidhjes së ligjshme dhe efektive të lëndës. Prandaj Paneli Shqyrtues i bazoi konstatimet e tij në dispozitat relevante të LPP, të cilat parashohin dhe rregullojnë situata të tilla, e që mund të paraqiten gjatë një aktiviteti të prokurimit.

Për pikën I dhe II të vendimit është vendosur duke u bazuar në nenin 117 të LPP lidhur me nenin 29 të Rregullores së Punës së OSHP.

Për pikën III të vendimit është vendosur duke u bazuar në nenin 31 paragrafin 5 të Rregullores së Punës së OSHP lidhur me nenin 118 të LPP.

Nga sa u tha më sipër është vendosur si në dispozitiv të këtij vendimi.



Kryetar i Panelit Shqyrtues

Kimete Gashi

Këshillë juridike:

Kundër këtij vendimi nuk është e lejuar ankesa, por pala e pakënaqur me kërkesëpadi mund t'i drejtohet Gjykatës Komerciale - Departamentit për çështje Administrative për anulim vendimi në afat prej 30 ditësh nga data e pranimit të vendimit.

Vendimi t'i dorëzohet:

- **AK - KUVENDI I KOMUNES SE PRISHTINES**
- **OE - ASSET ING SH.P.K.**
- Arkivës së OSHP-së: